

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti I Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Ramiz Azizi, me praktikanten Antigone Haziri, në lëndën penale ndaj të akuzuarit B. S nga Gj, të cilët me autorizim zëvendësues e mbron avokati ...nga Gj shkak të veprës së vazhdueshme penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1029/16 të datës 21.06.2015, të cilën e përfaqësonte prokurori i shtetit, Shefik Mehmeti, pas mbajtjes në seancën fillestare gjyqësore, publike dhe orale lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajsisë dhe dënimit në Prokurori të datës 21.06.2016 ,me datë 24.07.2017 publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. S nga i ati B, dhe nëna Re lindur B i lindur me datë .në fshatin N, Komuna e Bt, me vendbanim në Gj, nr., i martuar ,baba i një fëmije, e ka të kryer shkollën e mesme të hotelierisë ,i papunë, e gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, më pare i pagjykuar.

**Ë S H T Ë F A J T O R
S E P S E**

Në periudhën prej muajit janar të vitit 2012 e deri më 25.05.2015, në Gjilan, me qëllim t'i sjell vetes dobi pasurore e mashtron të dëmtuarin F.H nga fsh. së Komunes së Gj duke e sjellë të njëjtin në lajthim me anë të paraqitjes së rreme e duke i fshehur faktet dhe me këtë e shtytë të njëjtin të veprojë në dëm të pasurisë së tij, në atë mënyrë që e bindë të njëjtin se ky për një kohë mund t'ia rregulloj dokumentacionin e shtetit bullgar,si : Letërnjoftimin dhe nënshtetësinë Bullgare, por ky për këto punë që do t'ia kryej këtë duhet t'ia paguaj shumë prej 1570 euro dhe të pret një kohë, shumë kjo për të cilën i dëmtuari menjëherë i'a paguan të pandehurit , e pret për disa vite por puna nuk i kryhet edhe pse vazhdimisht prej këtij të pandehuri ka kërkuar që ajo t'i kryhet sepse i kishte premtuar dhe kështu i njëjti vazhdimisht për periudhën e lartpërmendur kohore prej këtij të pandehuri shtyhej që të shpenzonte edhe para te tjera deri në vlerën prej 4000- euro për t'a realizuar këtë qëllim, mirëpo ajo punë e premtuar këtij të dëmtuari asnjëherë nuk i'u krye dhe në këtë mënyrë ky i dëmtuar prej këtij të

pandehuri mbeti i mashtruar për disa vite në vazhdimësi dhe i dëmtuar për vlerën e të hollave prej rreth 4000 euro-ve.

-me çka ka kryer veprën e vazhdueshme penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të KPK-së.

Andaj, bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur, si dhe në nenet 4,7,17,23,41,42,43 ,46, 73, të KPK-së si dhe te neneve 365,451 e 463 të KPPRK-ës atij i shqipton

DENIM ME GJOBË

I. Të akuzuarit B. S. për veprën penale i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)€, të cilën gjobë do t'a paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm, në të kundërtën dënimi i shqiptuar m,e gjobë, do të zëvendësohet me dënim burgu.

II. Të pandehurit i shqiptohet edhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej 5 muaj dënim i cili nuk do të ekzekutohet, në qoftë se i pandehuri në afat verifikues prej 1viti, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën vendimi për dënimin e shqiptuar ka për t'u revokuar, ashtu qe i pandehuri ka për të vuajtur dënimin e sipërshtënuar me burg efektiv.

III. Obligohet i pandehuri që të dëmtuarin nga fshati, të ia kompenzoi dëmin e shkaktuar me mashtrim në shumë prej 1570.00 e (Një mijë e pesëqind e htatëdhjet euro) në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotëfuqishëm.

IV. I pandehuri obligohet që kompenzimi e dëmit në shumë prej 1.570,00 E (Një mijë e pesqindë e shtatëdhjetë euro) të e paguaj në 5 (pesë) këste mujore, ashtu që këstin e parë në shumën prej 370,00 E të e paguaj në fat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotëfuqishëm, ndërsa këstin e dytë , tretë, katërt dhe pestë nga 300,00 E të i paguaj në fillim të qdo muaji viues , njëri pas tjetrit dhe atë gjerë në pegesen e tërsishëm të kompesimit dëmit për mashtrim.

V. Në qoftë se i pandehur nuk e përmbushë detyrimin ashtu si është përcaktuar në pikën IV të kësaj marrëveshje , atëher dënimi i shqiptuar me burg sipas pikës II të kësaj marrëveshje ka për të u revokuar , ashtu që i pandehuri ka për ta vuajtur dënimin me burg efektiv në kohëzgjatje prej 5 muajve.

VI. I dëmtuari ka hequr dorë nga të gjitha kërkesat tjera pasurore juridike të qfardo natyre qovshin, në qoftëse i pandehuri e përmbushë në tërsi obligimin sipas kësaj marrëveshje, në të kundërtën për realizimin e kërkesave të tija pasurore juridike do ti drejtohet gjykatës kompetente.

I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontestin civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë 20 (njizetë) euro si dhe shpenzimet e procedurës penale te përlllogaritura sipas llogarisë perfundimtare te kësaj gjykate ,të gjitha këto në afatin 15 ditor pas marrjes së këtij aktgjykimi.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzen PP.II.nr.1029/2016 të dates 21.06.2015, kundër të akuzuarit , për shkak të vepres penale te vazhdueshme penale nga neni 335 paragrafi 1 të KPK-së.

Asnjëra palë nuk e kundërshtoi gjyqtarin e vetëm gjykues, nuk pati asnjë vërejte ndaj të njëjtit.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë si dhe të sanksionit penal i është paraqitur gjyqtarit të vetëm gjykues konform nenit 233 të KPPRK-së më datën 07.06.2017, e cila si e tërë është edhe pjesë përbërëse e kësaj lënde penale.

Për veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të KPK-së, është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 1 vit.

Përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjilan, prokurori i shtetit Shefik Mehmeti, e ka njoftuar gjyqtarin e vetëm gjykues për dhënien e pëlqimit me

shkrim nga ana e kryeprokurorit dhe për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal, duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve të propozuar si dhe të shtjellimit të provave të tjera materiale.

Mbrojtësi i të akuzuarit, avokati me autorizim ...nga Gj, e ka njoftuar gjyqtarin e vetëm gjykues për marrëveshjen në fjalë të lidhur me përfaqësuesin e akuzës në prezencën e të akuzuarit, duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe të shtjellimit të provave tjera, po ashtu duke kërkuar që dënimi për të akuzuarin të jetë dënim me gjobë e që të njëjtin nuk e kundërshtoi as prokurori, e as gjyqtari i vetëm gjykues e i cili këtë edhe e aprovoi.

Marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal për të akuzuarin, i përmbajnë të gjitha kushtet, duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimin të fajësisë dhe sanksionimit penal, e bërë në mënyrë vullnetare, duke deklaruar edhe për arsyet e pranimin të fajësisë si dhe të sanksionit penal.

Gjykata ka gjetur se palët procedurale marrëveshjet në fjalë i kanë bërë konform dispozitës ligjore të nenit 233 të KPPRK-së.

Gjykata është e bindur se i akuzuari e ka kryer veprën penale nga neni 335 i KPRK-së, si dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë diskualifikim i cekur nga neni 233 të KPPRK-së.

Pasi që palët procedurale, prokurori i shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij që ishte prezent në seancën dëgjimore, kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal, gjykata atë e mori dhe e pranoi pa kurrfarë hezitimi si të arritur me vullnet nga palët procedurale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarit në fjalë, gjyqtari i vetëm gjykues mori për bazë marrëveshjen mbi pranimin vullnetar të fajësisë dhe të sanksionit penal ndaj të akuzuarit të lartcekur si dhe rrethanat tjera lehtësuese si sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin për atë qka kishte bërë, premtimin se një gjë të tillë atë kurrë nuk do ta përsërisë, është, hera e parë që ndeshet me ligjin, e si rrethana rënduese mori parasysh vendin e kryerjes së veprës si dhe pasojat e shkaktuara të dëmtuarit.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar me gjobë është në harmoni me peshën e veprës penale, kështu që me këtë dënim do të mundet të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me neni 41 të KPRK-së.

Përfaqësuesi i aktakuzës, i dëmtuari dhe mbrojtësi i tij deklaruan se heqin dorë nga ankesa.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 451,e aim bi kërkesën pasurore-juridike, në nenin 463 të KPPRK-së.

Andaj,nga të lartcekurat konform nenit 46,451 dhe 463 të KPRK-es, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti I Përgjittshëm
P.nr. 773/16 të datës 24.07.2017

Zyrtarja Ligjore
Florentina Ademi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE *Palët procedural kanë hequr dorë nga ankesa e këtij aktgjykim, andaj i njëjti nuk mundë të akimohet dhe bëhet menjëherë I formës së prerë.*